Partia e Pavarur Liberale (SLS)

E-mail:

vesimir.savić@assembly-kosova.org

Vesna Mikić

Pa Grup



Datëlindja: 26.02.1970

Vendbanimi: Gjilan

Arsimimi: Fakulteti i Psikologjisë

Pozita në Kuvend: /

Grupi Parlamentar: Pa Grup

E-mail:

vesna.mikić@assembly-kosova.org

Visar Ymeri

VETËVENDOSJEI



Datëlindja: 11.10.1973

Vendbanimi: Prishtinë

Arsimimi: Fakulteti i Sociologjisë

Pozita në Kuvend: Shefi i Grupit Parlamentar të VV-së dhe anëtar i Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Grupi Parlamentar:

Vetëvendosje (VV)

E-mail:

visar.ymeri@assembly-kosova.org

Vjollca Krasniqi



Datëlindja: 01.07.1970

Vendbanimi: Prishtinë

Arsimimi: Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Pozita në Kuvend: Anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Grupi Parlamentar:

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

E-mail: vjollca.krasniqi@assembly-kosova.org

Vjosa Osmani



Datëlindja: 17.05.1982

Vendbanimi: Prishtinë

Arsimimi: Doktor i Shkencave Juridike

Pozita në Kuvend: Anëtare e Komisionit për Integritet Evropian

Grupi Parlamentar:

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

E-mail:

vjosa.osmani@assembly-kosova.org

Xhavit Haliti



Datëlindja: 08.03.1956

Vendbanimi: Prishtinë

Arsimimi: Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Pozita në Kuvend: Nënkryetar i Kuvendit
Zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Integritet Evropian

Grupi Parlamentar: Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

E-mail: xhavit.haliti@assembly-kosova.org

Xhevahire Izmaku



Datëlindja: 15.08.1971

Vendbanimi: Vushtrri

Arsimimi: Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Pozita në Kuvend: Anëtare e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Grupi Parlamentar:

Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

E-mail: xhevahire.izmaku@assembly-kosova.org

Xhevdet Neziraj

IRDK



Datëlindja: 10.04.1961

Vendbanimi: Pejë

Arsimimi: Fakulteti i Ekonomisë

Pozita në Kuvend: Anëtarë i Komisionit për Buxhet dhe Financa

Grupi Parlamentar:

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovë (AAK)

E-mail:

xhevdet.neziraj@assembly-kosova.org

Zenun Pajaziti



Datëlindja: 12.09.1966

Vendbanimi: Prishtinë

Arsimimi: Fakulteti Teknik

Pozita në Kuvend: Kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri


Grupi Parlamentar:

Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

E-mail:

zenun.pajaziti@assembly-kosova.org





II. Përfaqësimi politik në Kuvendin e Kosovës

Legjislatura e IV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës, doli nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010 dhe përsëritjes së pjesshme të procesit zgjedhor me 09 dhe 23 janar 2011. Seanca konstituive e Legjislaturës së IV-të të Kuvendit të Kosovës u mbajt me 21.02.2011

Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare, përfaqësimi politik në Kuvendin e Kosovës ka ndërruar relativisht shumë. Subjekti më i madh politik në vend Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka zbehur shkëputjen të cilën e ka pasur në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve të vitit 2007, dhe nga (37) mandate tani ka (34) të tilla.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka shënuar një rritje solide nga (25) mandate në (27) dhe tani dallimi në mes partisë së parë dhe të dytë qëndron në (7) mandate deputetësh, e jo (12) sa ishte në mandatin e kaluar. Lëvizja Vetëvendosje deri në këto zgjedhje ishte një lëvizje jashtë institucionale e cila kryesisht njihej për qëndrime kundërshtuese ndaj rendit juridiko-kushtetues dhe institucioneve të krijuara në mbështetje të dokumentit gjithëpërfshirës të Presidentit Martti Ahtisaari. Lëvizja Vetëvendosje pas vendimit për të garuar në zgjedhje, shënoi një sukses të rëndësishëm, duke fituar 14 mandate në Kuvend.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), si subjekti më aktiv opozitar dhe si grupi i tretë parlamentarë gjatë mandatit të legjislaturës së kaluar në Kuvendin e Kosovës, në këto zgjedhje fitoi 12 mandate. Duke pasur parasysh rezultatin e këtij subjekti politik në zgjedhjet komunale (2009), 12 mandate në Kuvendin e Kosovës nuk mund konsiderohen si ndonjë sukses për këtë subjekt politikë.

Aleanca Kosova e Re (AKR) në këto zgjedhje hyri me një koalicion të gjerë me disa subjekte politike: Partinë e Drejtësisë, Partinë Sociale Demokrate, Partinë Nacionale Demokratike Shqiptare (me 28 shkurt 2011 është larguar nga koalicioni), Partinë e Pensionistëve Invalidor, Partinë e Pensionistëve të Kosovës, Partinë e Gjelbër dhe Grupin e Eksperteve E15. Ky koalicion tani në Kuvend ka gjithsejtë tetë (8) mandate në krahasim me 14 mandate sa kishte fituar në 2007.

Partia më e madhe serbe në Kuvendin e Kosovës, Srbska Liberalna Stranka (SLS) ka fituar 8 mandate. Në Kuvend tani do të kemi edhe dy parti të tjera serbe JSL me katër (4) deputetë dhe SDKSIM me një (1) deputet. Partia që përfaqëson komunitetin turk - KDTP vazhdon edhe në këtë legjislaturë t'i ketë tre (tre) deputet. Partitë e tjera janë me sa vijon: VAKAT dy (2) mandate, kurse nga një (1) mandat kanë GIG, BSDAK, PAI, PREBK, PDAK, IRDK dhe NDS¹.

Struktura përfaqësuese në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk ka ndërruar vetëm në numrat e mandateve të fituara nga subjektet politike, ndryshimi më i madh ka ndodhur me vetë deputetët e legjislaturës paraprake, ku nga 120 deputet sa ka Kuvendi i Kosovës vetëm 37 prej tyre kanë ar-

¹[http://www.kqz-ks.org/SKOZ-WEB/al/zgjedhje te Kosoves/zgjedhjetepergjithshme.html](http://www.kqz-ks.org/SKOZ-WEB/al/zgjedhje%20te%20Kosoves/zgjedhjetepergjithshme.html)

ritur të ri-fitojnë besimin e elektoratit. Kjo në fakt është ndërrim radikal dhe mund të paraqes vështirësi në funksionimin normal të Kuvendit, pasi që me 83 deputet të rinj mund të vështirësohet kontinuiteti i punës së Kuvendit të Kosovës. Bazuar në praktikat e vendeve me sisteme të konsoliduara parlamentare ndryshimet zakonisht nuk kalojnë 1/3 e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Meqenëse Kosova nuk ka mekanizma ligjorë për të siguruar këtë kontinuitet, do të ishte e qëlluar ideja e shfrytëzimit të përvojës së ish-deputetëve e veçanërisht e kryetarëve të komisioneve parlamentare. Kuvendi do të duhej që në disa takimet e para të mbledhjeve të komisioneve parlamentare t'i ftojë ish kryetarët e komisioneve përkatëse, të cilët do të mund të jepnin kontributin e tyre gjatë shqyrtimit të çështjeve të mbetura nga legjislatura e kaluar. Kjo do t'i ndihmonte në masë të madhe deputetët dhe kryetarët e rinjë të komisioneve që të mos e fillojnë punën e tyre nga zero, por të kenë një pasqyrë të përafërt lidhur me atë që është bërë dhe që ka mbetur të bëhet në këtë mandat².

²Intervistë me ish-kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Esat Brajshori.



III. Përfaqësimi gjeografik

Sistemi zgjedhor një-zonal po rrezikon vazhdimisht përfaqësimin sa më gjithëpërfshirës të komunave në Kuvendin e Kosovës. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 110 pika 1 Kosovën e konsideron një zonë unike zgjedhore me shumë kandidatë.

Rezultatet e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010, disa komuna i la të pa përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu disa komuna jo shumë të mëdha për nga numri i banorëve, kanë arritur të kenë numrin më të madh të deputetëve në krahasim me komunat të cilat janë më të mëdha si për nga numri i banorëve ashtu edhe për nga hapësira gjeografike. Raste të tilla padyshim se dëshmojnë për nevojën imediate të ndryshimit të legjislacionit zgjedhor, me theks të veçantë në ndarjen e Kosovës në më shumë zona zgjedhore.

Për më tepër, në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, në Nenin 2 mbi Parimet Themelore, thuhet se zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës. Por një gjë e tillë nuk po ndodh shpeshherë.

Përveç sistemit një zonal, edhe bastionet dhe ndërhyrjet e qendrave të partive në përzgjedhjen e kandidatëve konsiderohen si pengesa të përfaqësimit më të gjerë në Kuvend.

Sistemi zgjedhor proporcional me disa zona zgjedhore do të ishte

më i favorshëm për Kosovën. Kjo nuk do të garantonte me çdo kusht edhe përfaqësim të çdo komune, por do të garantojë një përfaqësim të barabartë dhe në përputhje me numrin e banorëve të çdo pjese të Kosovës. Deputeti në këtë rast nuk do të ketë obligime vetëm ndaj partisë por edhe ndaj zonës zgjedhore e cila e ka votuar duke e obliguar që të komunikojë me elektoratin dhe të transmetojë kërkesat e tyre. Këtu vetvetiu do të hyjë në funksion relacioni deputet – zonë zgjedhore, respektivisht obligimi i llogaridhënies ndaj zgjedhësve të tyre³.

a. Zonat më të përfaqësuara - bastionet e partive politike

Disa zona gjithmonë sigurojnë numër të konsiderueshëm të deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Kjo kryesisht ndodhë në ato zona që konsiderohen si bastione të partive të caktuara politike. Ky trend pothuajse ka vazhduar në të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë. Në bazë të ndikimit të partive politike tradicionalisht më të përfaqësuara kanë qenë zona e Drenicës, Dukagjinit dhe Llapit.

Vetëm nga dy qytetet nga rajoni i Drenicës, Skenderaj dhe Drenas vijnë 8 deputetë, bastion ky i njohur i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Rajoni i Dukagjinit do ti ketë 20 deputetë, rajoni i Llapit pesë deputetë, edhe pse një pjesë e madhe e deputetëve të LDK-së vijnë nga ky rajon, por që janë si të nominuar nga Prishtina.

Një nga bastionet e AAK-së, Deçani, do të jetë i përfaqësuar nga 6 deputetë, shumica nga AAK-ja. Peja do të ketë shtatë deputetë, 3 nga PDK-ja, dy nga LDK-ja, dhe nga një nga AAK-ja dhe AKR-ja. Kurse Gjakova do të jetë e përfaqësuar nga 7 deputetë, dy nga LDK-ja, dy nga AKR-ja, dy nga AAK-ja dhe një nga “Vetëvendosja”.

³Punimi i KDI-së “Zyrat e deputetëve: Mundësi për përfaqësim më të mirë të qytetarëve” KDI, 2010, fq.7

Si komuna më e madhe, ajo e Prishtinës do të ketë më së shumti deputet në Kuvendin e Kosovës, gjithsej 28 deputetë në total, prej të cilëve 6 nga PDK-ja, 9 nga LDK-ja, 7 nga “Vetëvendosja”, 3 nga AAK-ja dhe 5 nga AKR-ja.

Një shembull tjetër me interes për t’u analizuar është Komuna e Suharekës, e cila përkundër që nuk është aq komunë e madhe, do të jetë ndër më të përfaqësuarat në Kuvendin e Kosovës me gjithsej 7 deputetë, tre nga AAK-ja, dy nga PDK-ja, një LDK-ja dhe një nga Vetëvendosja (megjithëse një deputet i PDK-së, Enver Hoxhaj ka kaluar në ekzekutiv, duke e lëshuar një ulëse në Parlament). Ndërsa në fundin e mandatit të legjislaturës së kaluar, kjo komunë ka qenë e pa përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës.

b.Zonat e përfaqësuara

Për dallim nga komunat tjera të mëdha si ajo e Gjilanit apo Gjakovës që përfaqësohen me nga 7 deputetë, Ferizaj dallon shumë. Nga 91 mijë e 876 votues të regjistruar, këtë komunë do ta përfaqësojë vetëm një deputet që vjen nga PDK-ja. Në legjislaturën e kaluar, Ferizaj ka pasur gjithsej 7 deputetë, 6 më shumë se tani.

Ndërkohë, një komunë tjetër që ka rreth katër herë më pak votues të regjistruar, ajo e Shtimes do të përfaqësohet me dy deputetë, një nga PDK-ja, një nga LDK-ja.

Rasti më eklatant vlerësohet ai i komunës së Vitisë. Kjo komunë me 42 mijë e 882 votues të regjistruar, nuk ka arritur që të ketë asnjë deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.



IV. Përfaqësimi Etnik

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton komuniteteve pakicë 20 vende në Kuvend.

Në bazë të nenit 64, pika 2 thuhet se “*në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:*

(1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10)”.

Ndërkohë, partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t’i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara⁴.

Bazuar në këtë rregullim kushtetues, por edhe votat e fituara, në mandatin e katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës, komunitetet pakicë janë të përfaqësuara me 25 deputetë.

Komuniteti serbë përfaqësohet me 13 deputetë, që i bie se tre deputetë serbë më tepër sesa vendet e garantuara. Në zgjedhjet nacionale të nëntorit 2010, serbët dolën më shumë në zgjedhje, duke zgjedhur kështu tre deputetë, si dhe duke fituar dhjetë të tjerë.

Krahasuar me mandatin e kaluar, dalja më e madhe e serbëve në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 iu mundësoi që t'i kenë tre deputetë më shumë sesa vendet e garantuara. Ndërkohë, komunitetet tjera përfaqësohen me dymbëdhjetë (12) deputetë të tjerë, 10 nga to të garantuara.

Analizuar në tërësi, në mandatin e katërt të legjislativit, komunitetet përfaqësohen me një deputet më shumë, se në të kaluarën, me gjithsej 25 deputetë.

³Kushtetuta e Kosovës, neni 64, pika 1 dhe 2.

a. Përfaqësimi i komuniteteve në bazë të zonave gjeografike

Komunitetet etnike në Kosovë nuk janë të shtrirë në gjithë territorin e Kosovës. Prandaj, edhe votat e tyre janë të fokusuara në rajone të caktuara. Por, megjithatë është Kushtetuta e vendit ajo që u garanton ulëse në Kuvend edhe nëse nuk marrin vota të mjaftueshme.

Sa i përket komunitetit pakicë serbë, ata më së shumti përfaqësohen nga deputetë që vijnë nga pjesa qendrore e Kosovës, si Graçanica e Qagllavica. Serbët nga veriu nuk dolën as në zgjedhjet e fundit, megjithëse disa deputetë vijnë nga Mitrovica.

Pakicat tjera, turke, boshnjake, rome, ashkalinje, etj, kryesisht vijnë nga jugu i vendit, si Komuna e Prizrenit dhe Dragashit. Komuna e Prizrenit ka dalë si komuna që ka deputetë më së shumti nga komunitetet, me gjithsej katër deputetë nga pakicat.





V. Përfaqësimi Gjinator

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (LZPK) parasheh kuotën gjinore, si një detyrim ligjor për të garantuar përfaqësimin e 30% të femrave në Legjislativin e vendit.

Neni 27:

27.1 Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.

27.2 Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.

Kuota gjinore është i vetmi mekanizëm që ka ngritë nivelin e pjesëmarrje së grave në politike. Kuota 30%, po ashtu ka ndikuar në rritjen e numrit të grave në partitë tona politike dhe jetën politike në përgjithësi. Praktika e kaluar ka treguar se mos përcaktimi me ligj i kuotës prej 30% ka rezultuar me një përfaqësim tejet simbolik të gjinisë femërore në Kuvendin e Kosovës.

Natyrisht që vetëm kuota nuk është i vetmi mekanizëm që sjellë barazi në shoqëri. Në Kosovë përcaktimi i kuotës nuk ka sjell vetëm sasinë, por ka sjell edhe cilësinë sepse një pjese të grave që kanë hyrë falë kësaj

kuote në jetën politike, më pas kanë arritur që të marrin vota të mjaftueshme për të qenë përfaqësuese në Kuvendin e Kosovës. Kjo u dëshmuar edhe nga rezultati i zgjedhjeve të fundit parlamentare ku në krahasim me legjislaturën e kaluar ku ishin 37 femra deputete, në legjislaturën e IV do të jenë të përfaqësuar 40 deputete.

Nga 16 komisione parlamentare sa kishte në mandatin e kaluar Kuvendi i Kosovës, dy prej tyre janë udhëhequr nga deputetet femra (Zylfije Hundozi dhe Myzejene Selmani), ndërkaq asnjë nga shefat e grupeve parlamentare nuk ka ishte femër, ashtu siç nuk ka pasur as një anëtare të Kryesisë së Kuvendit .

Edhe në legjislaturën e tanishme, nga 13 komisione parlamentare sërish do të kemi vetëm dy femra kryetare të komisioneve (Safete Hadërgjonaj dhe Suzanë Novobërdaliu), po ashtu edhe më tutje Kryesia e Kuvendit do të mbetet e pa përfaqësuar nga asnjë femër.

Deputetet të cilat kanë arritur të ruajnë vendin e tyre edhe në këtë mandat legjislativ janë dhjetë: Flora Brovina, Vlora Çitaku, Sala Berisha –Shala, Safete Hadërgjonaj, Donika Kadaj-Bujupi, Nekibe Kelmendi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Myzejene Selmani, Suzanë Novobërdaliu, Mufëra Srbica-Shinik. Deputetet më të votuara në këto zgjedhje ishin: Mimoza Kusari-Lila (AKR), Nekibe Kelmendi (LDK), Donika Kada-Bujupi (AAK), Vlora Çitaku (PDK). Duhet vlerësuar se njëmbëdhjetë (11) deputete femra janë të zgjedhura drejtpërdrejt nga votat e marra, pavarësisht kuotës gjinore.



VI. Përfaqësimi i të rinjve

Kuvendi i Kosovës në legjislaturën e katërt me radhë, ka shënuar një kthesë për sa i përket përfaqësimit të të rinjve në Kuvend. Organi më i lartë përfaqësues, për dallim nga hera e kaluar kur kishte vetëm (9) deputet të rinj, tani ky numër gati se është trefishuar pasi që tani ka (25) të tillë.

Në këtë legjislaturë më së shumti deputet të rinj ka Lëvizja Vetëvendosje (10), pastaj vijnë LDK me (4) deputet të rinj, AAK (4), PDK (4), AKR (1) dhe SLS (2). Kjo si dukuri mund të konsiderohet inkurajuese pasi që një numër kaq i madh i deputetëve të rinj tejkalon edhe shpresat optimiste për përfaqësim të barabartë të moshave në Kuvendin e Kosovës.





VII. Përfaqësimi profesional

“Kuvendi i juristëve dhe ekonomistëve”

Kuvendi i Kosovës ka një laramani prej 15 profesioneve të 120 deputetëve. Në këtë rreth përfshihen edhe një numër i vogël i atyre që nuk kanë shkollim universitar.

Nga gjithsej 120 deputetë, tre profesionet më të dominuar janë: juristët 19.2 %, ekonomistët 14.1 % dhe mjekët 10.8 %.

Ndërkohë niveli i deputetëve me përgatitje më të lartë akademike, është 16.6 % nga 120 deputetë. Të diplomuar në nivelin bachelor janë 78 %. Ndërkohë, 5.8 % nuk kanë fare përgatitje universitare.

Në Kuvendin e Kosovës, nga 120 deputetë, një është akademikë, 08 doktorë shkence dhe 11 magjistra, që kompletojnë numrin prej 20, apo 16.6 %.

Profesioni që më së shumti dominon këtë legjislaturë është ai i drejtësisë. Gjithsej 23, apo 19 % e deputetëve janë juristë, që bazuar në rolin që ka legjislativi, vlerësohet përparësi.

Ndërkohë, profesioni i dytë që dominon në legjislaturë është ai i ekonomistëve, gjithsej 16, apo 13 %.

Në vendin e tretë për nga numri në Kuvend, janë mjekët. Kuvendi ka gjithsej 13 mjekë, apo 10.8 %.

112
Control

112

Yes
No
Abstain
Not voted



40 Yes
55 No
5 Abstain

Ad
(Current Voting)



VIII. Dëgjimet Publike

Kuvendi si organi kryesorë përfaqësues në vend, njërën nga kompetencat kryesore e ka bërjen e ligjeve. Procesi i hartimit dhe diskutimit të ligjeve jo çdo herë është i mjaftueshëm vetëm përbrenda një komisioni apo vetë deputetëve. Andaj dëgjimet publike janë mekanizëm i Kuvendit që të marrë informata dhe ekspertizë nga grupet e interesit, ekspertët apo edhe vetë qytetarët lidhur me projektligjet të cilat janë në hartim, kjo është një formë shumë efektive e cila përveç se inkorporon sugjerimet, komentet dhe propozimet e qytetarëve gjithashtu i bënë më legjitime vendimet.

Në procesin e hartimit të ligjeve dhe dokumenteve të tjera si kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Kosovës me Rregulloren e Punës së Kuvendit parasheh dhe inkurajon edhe përfshirjen e qytetarëve dhe veçanërisht OJQ-ve në procesin e konsultimeve publike. Kuvendi i Kosovës procesin e konsultimeve e ka garantuar përmes dokumentit të vet organizativ, Rregullores së punës e cila thotë: Komisioni mund të mbajnë dëgjime publike për çështjet që janë në shqyrtim e sipër, me ekspertë të organizatave publike, përfaqësues të grupeve të interesit dhe të personave të tjerë. Për t'i sqaruar faktet komisioni mund të diskutojë gjerësisht me personat që ofrojnë njoftime.

Dëgjimet publike jo çdo herë mbahen vetëm për çështjet e ligjeve. Në praktikë njihen edhe forma të tjera të organizimit të tyre. Ndarja kryesore e dëgjimeve publike bëhet varësisht nga

qëllimi i organizimit, andaj themi se dëgjimet publike ndahen në tri lloje:

1. Dëgjimet Publike Legjislative;
2. Dëgjimet Publike Mbikqyrëse;
3. Dëgjimet Publike Hetimore.

Dëgjimet Publike Legjislative janë më të shprehura dhe më praktikuara në Kuvendin e Kosovës, dhe zakonisht Komisionet Parlamentare i thërrasin palët e interesuara apo organizatat e fushës së caktuar kompetente për të diskutuar lidhur me një Projektligj i cili është në procedurën e hartimit apo diskutimit.

Dëgjimet Publike Mbikëqyrëse, edhe pse janë më të rralla në Kuvend, gjithashtu i shërbejnë këtij organi për të thirrur në përgjegjësi apo për të diskutuar lidhur me zbatimin e ligjeve dhe programeve qeveritare në vend. Në fakt monitorimi i zbatimit të ligjeve është njëra ndër kompetencat kryesore të komisioneve parlamentare e që dita ditës duket se po fuqizohet në kuptimin e ushtrimit të saj.

Dëgjimet publike zakonisht mbahen dhe janë mbajtur brenda hapësirës së Kuvendit, mirë po në praktikë gjithnjë më shumë po shprehet nevoja që Kuvendi të dalë dhe të mbledhë informata dhe të shoh vetë gjendjen faktike në terren, pasi që kjo gjë do të afronte Kuvendin me qytetarët.

IX. Procedura e Miratimit të Ligjeve

Procedura për miratimin e ligjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 80), dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit (neni 53).

a. Kush ka të drejtë për nismë legislative?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 79 të saj ka përcaktuar se nismën për të propozuar ligje e kanë:

- Presidenti i Republikës së Kosovës
- Qeveria
- Deputetët e Kuvendit
- ose më së paku dhjetëmijë qytetarë sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

b. Kushtet e parashtrimit të një projektligji

Projektligji i cili paraqitet në Kuvend duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 54)

Projektligji i cili paraqitet në Kuvend duhet të përmbajë:

- Shkresën shpjeguese (arsyeshmërinë)
- Deklaratën për ndikimin buxhetor
- Objektivat
- Deklaratën për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit me BE.

c. Si të adresohet një projektligj në Kuvend

Projektligji pavarësisht se nga kush është ndërmarrë nisma legjislative duhet të dërgohet në Zyrën për Parashpresa e cila verifikon aspektin formal-juridik të projektligjit, e regjistron sipas rendit të paraqitur dhe ua dërgon deputetëve. Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e parë të radhës, e cakton komisionin funksional për shqyrtimin e projektligjit në parim.

Komisioni funksional – kryesor të cilit i bie barra e shqyrtimit të projektligjit, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit në parim në seancën plenare.

d. Leximi i parë

Shqyrtimi i parë i projektligjit në seancë plenare paraqet fazën fillestare të trajtimit të tij nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy (2) javë pune dhe as më vonë se katër (4) javë pune, nga dita e shpërndarjes së tij.

Shqyrtimi i projektligjit në parim fillon prezantimin e tij nga ana e sponzorizuesit, vazhdon më pas me raportin-rekomandimet e komisionit funksional duke u pasuar më pas me deklaratimet e grupeve parlamentare, deputetëve në veçanti dhe në fund përmbillet duke e votuar atë në parim.

Megjithatë propozuesit i njihet e drejta që gjatë shqyrtimit në Kuvend ta tërheq projektligjin deri para fillimit të votimit në leximin e dytë.

Pas miratimit në parim projektligji kalon në fazën e shqyrtimit në komisionin funksional-raportues si dhe në komi-

sionet: për Buxhet dhe Financa, për Legjislacion dhe Gjyqësi, për Integritime Evropiane, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticionet dhe Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Gjatë kësaj periudhe mund të propozojnë amendamente: deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe qeveria në afat prej dy javësh pas miratimit në parim. Gjatë kësaj kohe komisioni funksional mund të organizojë dëgjime publike për të diskutuar më gjerësisht rreth përmbytjes së projektligjit.

Komisioni funksional ia paraqet rekomandimet Kuvendit në seancë plenare në afat prej dy (2) muajsh nga miratimi në parim.

e. Leximi i dytë

Leximi i dytë fillon me prezantimin e raportit të komisionit funksional në lidhje me projektligjin. Më pas të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme parlamentare, grupet parlamentare, përfaqësuesit nga kabineti qeveritar dhe deputetët.

Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit, bëhet edhe votimi një nga një i amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, komisionet tjera, grupet parlamentare, qeveria dhe deputetët. Pas miratimit të amendamenteve projektligji i nënshtrohet votimit së bashku me ndryshimet e miratuara.

f. Leximi i tretë

Në rast se Kuvendi i Kosovës nuk arrinë që ta miratoj projektligjin në leximin e dytë atëherë ai mund të shkojë edhe në leximin e tretë së bashku me amendamentet e miratuara.

g. Miratimi i projektligjit

Nëse projektligji kalon me sukses në Kuvendin e Kosovës në leximin e dytë apo të tretë, atëherë ai shpallet Ligj dhe dërgohet për nënshkrim Presidentit të Republikës së Kosovës. Me këtë edhe përfundon procesi ligjvënës në Kuvendin e Kosovës.



X. Komisionet parlamentare

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa

Kryetare e Komisionit: Safete Hadergjonaj - PDK

Zëvendëskryetar i parë: Naser Osmani - LDK

Zëvendëskryetare e dytë: Jelena Bontić - SLS

Anëtarë të Komisionit:

Latif Gashi - PDK

Hasime Krasniqi - PDK

Hykmete Bajrami - LDK

Sali Asllanaj - LDK

Albana Fetoshi - VV

Xhevdet Neziraj - AAK

Muhamet Mustafa - KKR

Duda Balje - 6+

2. Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryetar i Komisionit : Saša Rašić - SLS

Zëvendëskryetare e parë: Myzejene Selmani - KKR

Zëvendëskryetar i dytë: Albert Kinolli - 6+

Anëtar të Komisionit:

Lumnije Morina - PDK

Agim Kuleta - VV

Jelena Bontić - SLS

Müfer Şinik - 6+

Lirije Kajtazi - LDK

Jasmina Živković - SLS

Petar Miletić - SLS

Rasim Demiri - 6+

3. Komisioni për Legjislacion

Kryetar i Komisionit: Arben Gashi LDK

Zëvendëskryetar i parë: Behar Selimi PDK

Zëvendëskryetar i dytë: Müfera Şinik 6+

Anëtar të Komisionit:

Arsim Bajrami - PDK

Halit Krasniqi - PDK

Haki Demolli - LDK

Armend Zemaj - LDK

Albulena Haxhiu - VV

Ardian Gjini - AAK

Ibrahim Makolli - KKR

Jasmina Živković - SLS

4. Komisioni për Integritet Evropian

Kryetar i komisionit: Lutfi Haziri - LDK

Zëvendëskryetar i parë: Xhavit Haliti - PDK

Zëvendëskryetar i dytë: Saša Milosavljević - SLS

Anëtar të komisionit:

Fatmir Limaj - PDK

Blerta Deliu-Kodra - PDK

Vjosa Osmani - LDK

Nekibe Kelmendi - LDK

Alma Lama - VV

Blerim Shala - AAK

Suzan Novoberdali - KKR

Albert Kinolli - 6+

5. Komisioni për Punë të Jashtme

Kryetar i komisionit: Albin Kurti -VV

Zëvendëskryetar i parë: Hydajet Hyseni - PDK

Zëvendëskryetar i dytë: Enis Kervan - 6+

Anëtar të komisionit:

Shaip Muja - PDK

Skender Hyseni - LDK

Sabri Hamiti - LDK

Donika Kadaj-Bujupi - AAK

Amir Ahmeti - KKR

Petar Miletić - SLS

6. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetar i komisionit: Idriz Vehapi - PDK

Zëvendëskryetar i parë: Eqrem Kryeziu - LDK

Zëvendëskryetar i dytë: Enis Kervan - 6+

Anëtar të komisionit:

Ramë Vataj - PDK

Xhevahire Izmaku - PDK

Lirije Kajtazi - LDK

Sadri Ferati - LDK

Afrim Kasolli - VV

Teuta Haxhiu - AAK

Jeton Svirca - KKR

Vesimir Savić - SLS

7. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetar i komisionit: Zenun Pajaziti - PDK

Zëvendëskryetare e parë: Teuta Sahatqija - LDK

Zëvendëskryetar i dytë: Fikrim Damka - 6+

Anëtar të komisionit:

Sala Berisha-Shala - PDK

Berat Bushala - PDK

Lutfi Zharku - LDK

Hashim Deshishku - LDK

Visar Ymeri - VV

Ramiz Kelmendi - AAK

Myzejene Selmani - KKR

Biserka Kostić - SLS

8. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetar i komisionit: Fikrim Damka Grupi - 6+

Zëvendëskryetare e parë: Time Kadriaj - AAK

Zëvendëskryetar i dytë: Saša Đokić - SLS

Anëtar të komisionit:

Flora Brovina - PDK

Salihe Mustafa - PDK

Bahri Thaçi - LDK

Nazane Breca - LDK

Aurora Bakolli - VV

Gezim Kelmendi - KKR

9. Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Kryetar i komisionit: Nait Hasani - PDK

Zëvendëskryetar i parë: Liburn Aliu - VV

Zëvendëskryetar i dytë: Rasim Demiri Grupi - 6+

Anëtar të komisionit:

Nijazi Idrizi - PDK

Salih Morina - LDK

Afërdita Berisha-Shaqiri - LDK

Daut Haradinaj - AAK

Sevdie Lama - KKR

Etem Arifi - SLS

10. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryetar i komisionit: Ahmet Isufi AAK

Zëvendëskryetar i parë: Rexhep Selimi Vetëvendosjes

Zëvendëskryetar i dytë: Goran Marinković SLS

Anëtar të komisionit:

Fatmir Xhelili - PDK

Ganimete Musliu - PDK

Anton Quni - LDK

Vjollca Krasniqi - LDK

Ibrahim Makolli - KKR

Rasim Demiri - 6+

11. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë

Kryetar i komisionit: Florin Krasniqi Vetëvendosje

Zëvendëskryetar i parë: Fadil Demaku PDK

Zëvendëskryetar i dytë: Boban Todorović SLS

Anëtar të komisionit:

Bekim Haxhiu - PDK

Haki Demolli - LDK

Imri Ahmeti - LDK

Burim Ramadani - AAK

Ukë Rugova - KKR

Duda Balje Grupi - 6+

12. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryetar i komisionit: Ali Sadriu - LDK

Zëvendëskryetar i parë: Ramiz Lladrovci - PDK

Zëvendëskryetar i dytë: Murselj Haljilji - SLS

Anëtar të komisionit:

Valbona Dibra - PDK

Armend Zemaj - LDK

Afrim Hoti - VV

Bali Muharremaj - AAK

Muhamet Mustafa - KKR

Albert Kinolli Grupi - 6+

13. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryetar i komisionit: Suzan Novoberdali - KKR

Zëvendëskryetare e parë: Rita Hajzeraj-Beqaj - LDK

Zëvendëskryetare e dytë: Biserka Kostić - SLS

Anëtar të komisionit:

Justina Shiroka-Pula - PDK

Kurtan Kajtazi - PDK

Ismet Beqiri - LDK

Albana Gashi - VV

Kymete Bajraktari - AAK

Duda Balje Grupi - 6+



XI. Grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës

1. Partia Demokratike e Kosovës (PKD)

Kryetar i grupit parlamentar: Adem Grabovci

Anëtarët:

Jakup Krasniqi

Xhavit Haliti

Safete Hadergjonaj

Latif Gashi

Hasime Krasniqi

Lumnije Morina

Arsim Bajrami

Behar Selimi

Halit Krasniqi

Fatmir Limaj

Blerta Deliu-Kodra

Hydajet Hyseni

Shaip Muja

Idriz Vehapi

Ramë Vataj

Xhevahire Izmaku

Zenun Pajaziti

Sala Berisha-Shala

Berat Bushala

Flora Brovina

Salihe Mustafa

Nait Hasani

Nijazi Idrizi

Fatmir Xhelili

Ganimete Musliu

Fadil Demaku

Bekim Haxhiu

Ramiz Lladrovci

Valbona Dibra

Justina Shiroka-Pula

Kurtan Kajtazi

Azem Syla

Elmi Reçica

2. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Kryetar i grupit parlamentar: Ismet Beqiri

Anëtarët:

Sali Asllanaj	Naser Osmani
Hykmete Bajrami	Lirije Kajtazi
Arben Gashi	Haki Demolli
Armend Zemaj	Lutfi Haziri
Vjosa Osmani	Nekibe Kelmendi
Skender Hyseni	Sabri Hamiti
Eqrem Kryeziu	Sadri Ferati
Teuta Sahatqija	Lutfi Zharku
Hashim Deshishku	Bahri Thaçi
Nazane Breca	Salih Morina
Afërdita Berisha-Shaqiri	Anton Quni
Vjollca Krasniqi	Imri Ahmeti
Ali Sadriu	Rita Hajzeraj-Beqaj

3. Lëvizja Vetëvendosje

Kryetar i grupit parlamentar: Visar Ymeri

Anëtarët:

Glauk Konjufca
 Albana Fetoshi
 Agim Kuleta
 Albulena Haxhiu
 Alma Lama
 Albin Kurti
 Afrim Kasolli
 Aurora Bakolli
 Liburn Aliu
 Rexhep Selimi
 Florin Krasniqi
 Afrim Hoti
 Albana Gashi

4. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

Kryetar i grupit parlamentar: Ardian Gjini

Anëtarët:

Blerim Shala

Donika Kadaj-Bujupi

Teuta Haxhiu

Ramiz Kelmendi

Time Kadriaj

Daut Haradinaj

Ahmet Isufi

Burim Ramadani

Bali Muharremaj

Kymete Bajraktari

Xhevdet Neziraj IRDK

5. Partia e Pavarur Liberale (SLS)

Kryetar i grupit parlamentar: Saša Rašić

Anëtarët:

Jelena Bontić

Petar Miletić

Jasmina Živković

Saša Milosavljević

Vesimir Savić JSL

Biserka Kostić

Etem Arifi PAI

Saša Đokić SDSKIM

Goran Marinković

Boban Todorović

Murselj Haljilji GIG

6. Koalicioni për Kosovë të re (KKR)

Kryetar i grupit parlamentar: Ibrahim Makolli

Anëtarët:

Muhamet Mustafa

Suzan Novoberdali

Amir Ahmeti

Jeton Svirca

Myzejene Selmani

Gezim Kelmendi

Sevdie Lama

Ukë Rugova

7. Grupi 6+

Kryetar i grupit parlamentar: Rasim Demiri VAKAT

Anëtarët:

Enis Kervan KDTP

Duda Balje VAKAT

Albert Kinolli PREBK

Müfera Şinik KDTP

Fikrim Damka KDTP

8. Pa Grup

Anëtarët:

Hamza Balje BSDAK

Vesna Mikić JSL

Emilija Redžepi NDS

Rada Trajković JSL

Sreten Ivanović JSL

Danush Ademi PDAK

Mendimet e shprehura në tekst janë të autorit. Ky publikim është bërë i mundur nga përkrahja e ofruar prej USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërise Civile në Kosovë të implementuar nga ISC; NED dhe Ambasada Mbretërore Norvegjeze.

Mišljenja izražena y tekstu su autorska. Ovu su publikaciju omogućili:

